



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Komisioni për Buxhet dhe Financa**

**Legjislatura e III-të**

**Nr. 42/09**

**Prishtinë, më 26.01.2009, ora 11:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203**

**PROCESVERBAL**

nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

**Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Gani Koci, Haki Shatri, Kosara Nikolić, Besa Gaxherri, Myrvete Pantina, Shkumbin Demaliaj, Müfera Şinik, Xhevdet Neziraj, Hajdin Abazi, Riza Smaka, Safete Hadërgjonaj.**

**Anëtarët jo të pranishëm: Naser Osmani.**

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Natasha Prica-Tisma, Vilson Ukaj, Dashurije Canolli.

Gjithashtu të pranishëm ishin: Teki Shala, Shefki Kastrati nga NDI, monitorues Zyra e Presidentit, OSCE, KDI.

**Kryesues: Gani Koci, Kryetar i Komisionit.**

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 19 janar 2009**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për Ushqimin me raportin e komisionit funksional – Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor me raportin komisionit funksional - Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe planifikim Hapësinor, me amendamente**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit për Mbrojtjen e Mjedisit me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe planifikim Hapësinor, me amendamente**

6. **Shqyrtimi i Projektligjit për Vlerësimin e Ndikimit ne Mjedis me raportin e komisionit funksional -Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor,me amendamente**
7. **Shqyrtimi i rekomandimeve të Komisionit lidhur me procesimin e listës së pagave të Agjencioneve të Pavarura**
8. **Të ndryshme.**

**Kryesuesi- Gani Koci**, hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendit ditës miratohet pa ndryshime.

### **2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 19 janar 2009**

**Besa Gaxherri**, kërkoi në procesverbalin e dt. 17 dhjetorit 2008, pika e dytë e rendit të ditës të korrigjohet shprehja se e përkrah projektin sheshi Isa Boletini që është më i arsyeshëm se disa kërkesa për ndërtimin e shkollave.

**Kryesuesi - Gani Koci**, konstatoi se procesverbalet nga mbledhjet e kaluar dt. 19 janar 2009 miratohet pa vërejtjet.

### **3. Shqyrtimi i Projektligjit për Ushqimin me raportin e komisionit funksional – Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente**

**Kryesuesi - Gani Koci**, theksoi se pas marrjes së deklaratës financiare të kërkuar nga Komisioni, shifet se Agjencioni i ri i krijuar me këtë Projektligj shkakton kosto shtesë buxhetore. Mirëpo në buxhetin e Kosovës për vitin 2009 është përfshirë shuma buxhetore për funksionimin e këtij agjencioni, pjesë e së cilit do të jetë bashkimi i disa institucioneve ekzistuese në këtë agjencion dhe bashkë me të edhe buxheti i tyre. Prandaj propozoi që Komisioni të rekomandoj që të miratohet Projektligji dhe të konstatoi se me rishikimin e buxhetit, MEF-i të shikoj mundësinë e ndikimeve buxhetore që mund të shkaktohen nga krijimi i kostove shtesë buxhetore për këtë agjencion.

**Haki Shatri**, theksoi se Komisioni mund të rekomandoj që stafi dhe buxheti për këta punëtorë të përqendrohen në këtë agjencion, ndërsa me rishikimi nëse nuk mjaftojnë këto mjete buxhetore të shikohet mundësia e plotësimit të tyre.

**Safete Hadërgjonaj**, u pajtua me konstatimet që Komisioni të rekomandoj për miratimin e Projektligjit. Duke komentuar koston buxhetore shtesë që mund të shkakton funksionimi i agjencionit, theksoi se Pika II B e deklaratës financiare tregon se në buxhetin e Kosovës për vitin 2009 janë paraparë mjete buxhetore për këtë agjencion, gjë që tregon një bazë të mirë për funksionimin e agjencionit, ndërsa me rishikim të buxhetit, të shikohet nevoja për plotësim të mjeteve shtesë për funksionimin e mëtutjeshëm të këtij agjencioni.

**Myrvete Pantina**, u pajtua me mendimet për procedimin e këtij Projektligji, implementimi i të cilit do të krijonte të hyra për buxhetin e Kosovës. Duke komentuar krijimin e Këshillit Shkencor, theksoi se funksionimi i tij është i domosdoshëm sepse ai do të merrej me çështje detale në fushën përkatëse, për dallim prej Bordit këshillëdhënës që merret me politikën e përgjithshme.

**Besa Gaxherri**, theksoi se rëndësia e këtij ligji është e veçantë. Por duke pasur parasysh rregullat buxhetore, Ministria nuk ka arritur të ofroj raport financiar që parashikon mbulimet financiare që

shkaktohen nga zbatimi i këtij ligjit. Edhe pse përkrah miratimin e një ligj të këtillë, për arsyet e cekura, znj. Gaxherri theksoi se do të abstenoj në rekomandimin e Komisionit për këtë Projektligj.

**Shkumbin Demaliaj**, propozoi që në rekomandimin e Komisionit të thuhet se krijimi i Këshillit është i panevojshëm, Ministria përkatëse për nevoja shkencore të blej shërbime për projekte të caktuara, e jo për këto qëllime të parashihet punësimi i punëtorëve të rinj. Kjo madje nuk është në përputhje praktikat ndërkombëtare të sistemeve demokratike, në të cilat humbet rëndësia e krijimit të instituteve shtetërore.

**Xhevdet Neziraj**, theksoi se nuk është kundër miratimit të ligjit, por praktika po tregon që po miratohen ligje dhe nuk po zbatohen. Një rast i ngjajshëm është edhe me këtë projektligj i cili nuk mund të implementohet për shkak të implikimeve buxhetore që bart.

**Riza Smaka**, u pajtua me mendimet se nuk praktikohen themelimi i këshillave shkencore, për arsye se për tu quajtur shkencorë do të duhej të merrej me hulumtime, gjithashtu anëtarët duhet të jenë profesional dhe me grada shkencore. Megjithatë mbështeti miratimin e këtij ligji, por se propozoi që në dispozitat kalimtare, të hyrja në fuqi e ligjit, të thuhet se ky ligj hyn në fuqi por se aplikimi i tij shtyhet për më vonë, psh. në vitin 2010 për shkak të implikimeve buxhetore.

**Kryesuesi - Gani Koci**, duke iu përgjigjur parafolësit theksoi mjetet për funksionimin e këtij agjencioni ekzistojnë, prandaj nuk ka arsye që të kërkohet shtyerja e aplikimit, për arsye se në rishikim ekziston mundësia e shikimit të implikimeve buxhetore që mund të krijohen me këtë ndryshime. Në vazhdim propozoi që Komisioni të rekomandoj për miratimin e tij, ndërsa me rishikim të shikohen ndikimet buxhetore që mund të shkaktohen nga implementimi i këtij ligji..

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se me nëntë vota PËR, dy ABSTENIME (znj. Besa Gaxherri dhe z. Xhevdet Neziraj) dhe asnjë KUNDËR, Komisioni nxori këtë:

## REKOMANDIM

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për Ushqimin dhe raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

### II. Vërejtje konkrete:

Komisioni konstaton se për funksionimin e Agjencionit Kosovar të Ushqimit dhe Veterinarisë janë parashikuar mjetet buxhetore në buxhetin e Kosovës për vitin 2009. Me rishikimin e buxhetit të shikohet mundësia e ndikimeve buxhetore të këtij agjencioni.

4. **Shqyrtimi i Projektligjit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor me raportin komisionit funksional - Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente**

**Kryesuesi - Gani Koci**, njoftoi se Projektligji dhe amendamente e propozua nuk përmban implikime buxhetore, prandaj kërkoi që t'i rekomandojnë Kuvendit miratimin e tij.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

### **REKOMANDIM**

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për Vlerësimin Strategjik Mjedisor dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.
  - II. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente dhe ka konstatuar se amendamenti nuk përmban implikime buxhetore, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentin e propozuara.
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit për Mbrojtjen e Mjedisit me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe planifikim Hapësinor, me amendamente**

**Kryesuesi - Gani Koci**, njoftoi se Projektligji dhe amendamente e propozua nuk përmban implikime buxhetore, prandaj kërkoi që t'i rekomandojnë Kuvendit miratimin e tij.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

### **REKOMANDIM**

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për Mbrojtjen e Mjedisit dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.
  - II. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente dhe ka konstatuar se amendamenti nuk përmban implikime buxhetore, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentin e propozuara.
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit për Vlerësimin e Ndikimit ne Mjedis me raportin e komisionit funksional -Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente**

**Kryesuesi - Gani Koci**, njoftoi se Projektligji dhe amendamente e propozua nuk përmban implikime buxhetore, prandaj kërkoi që t'i rekomandojnë Kuvendit miratimin e tij.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

### **REKOMANDIM**

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për Vlerësimin e Ndikimit ne Mjedis dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente dhe ka konstatuar se amendamenti nuk përmban implikime buxhetore, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentin e propozuara.

## **7. Shqyrtimi i rekomandimeve të Komisionit lidhur me procesimin e listës së pagave të Agjencioneve të Pavarura**

**Kryesuesi - Gani Koci**, pyeti anëtarët nëse kanë vërejtje apo propozim lidhur me raportet në fjalë.

**Riza Smaka**, propozoi që rekomandimeve t'iu bashkangjitet një klauzë, me të cilën thuhet se kjo vlenë deri në miratimin e Ligjit për sistemin e pagave.

**Kryesuesi - Gani Koci**, theksoi se me rastin e miratimit të Ligjit për paga, këto rekomandime humbin fuqinë e tyre ligjore.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

### **P Ë R F U N D I M**

Miratohen rekomandimet e Komisionit lidhur me procesimin e listës së pagave të Agjencioneve të Pavarura.

## **8. Të ndryshme**

**Kryesuesi - Gani Koci**, kërkoi që grupet punuese të krijuara për shqyrtimin e Projektligjeve të fillojnë sa më shpejtë punën. Njoftoi se grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit për partneritetet publiko-private dhe koncesionet do të takohet të martën në ora 10:00.

**Safete Hadërgjonaj**, theksoi se pasi që është caktuar anëtare dhe raportuese e grupit punues për shqyrtimin e Projektligjit të Auditimit të Brendshëm, pas miratimit të tij në parim në Kuvend, së bashku me anëtarët tjerë do të caktojnë agjendën për shqyrtimin dhe amendamentimin e tij dhe brenda afatit do të prezantojnë raportin para Komisionit.

**Kryesuesi - Gani Koci**, njoftoi me propozimin e NDI-së për të angazhuar një ekspert për të ndihmuar në amendamentimin e Projektligjit për Lizingun Financiar.

Anëtarët unanimisht përkrahen këtë propozim.

**Kryesuesi - Gani Koci**, njoftoi anëtarët për arritjen e Raporti tre mujor të Trustit Pensional për tremujorin e IV-të të vitit 2008. Kërkoj pëlqimin e anëtarëve nëse ka nevojë për ta diskutuar atë.

**Safete Hadërgjonaj**, duke u ndërlidhur me këtë çështje, theksoi se ne mund ta diskutojm raportin, por se në anën tjetër nuk kemi caktuar tarifën menaxhuese si dhe nuk kemi miratuar buxhetin e tyre.

**Kryesuesi - Gani Koci**, duke iu përgjigjur parafolëses, theksoi se Komisioni ka dhënë rekomandimin lidhur me tarifën menaxhuese, por se puna ka ngecur në Kuvend.

Anëtarët unanimisht mbështetën propozimin që në mbledhjen e radhës së Komisionit, ndër pikat tjera të përfshihet edhe shqyrtimi i Raporti tre mujor të TKPK-së për tremujorin e IV-të të vitit 2008.

Mbledhja përfundoi në ora 12:00

**Përgatitur nga**  
**Njësia për mbështetjen e Komisionit**

**Kryesuesi i Komisionit,**

---

